

VENDIM
Nr. 118, datë 5.3.2014

PËR PROCEDURAT E EMËRIMIT, REKRUTIMIT, MENAXHIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL TË NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES DHE TË ANËTARËVE TË TND-së

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 28, pika 6, 29, pika 5, 30, pika 6, 31, pika 3, 32, pika 3, e 69, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton rregullat për:

- a) organizimin dhe funksionimin e Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në;
- b) rekrutimin e nëpunësve të TND-së nëpërmjet ASPA-s, ose drejtpërsëdrejti;
- c) emërimin e anëtarëve të TND-së;
- ç) pranimin e nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore;
- d) përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarët e TND-së.

KREU II
KOMISIONI KOMBËTAR I PËRZGJEDHJES PËR TND-në (KKP)

1. Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për TND-në ka në përbërje të tij 9 (nëntë) anëtarë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 31 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.
2. Përfaqësuesi nga DAP-i është, për shkak të detyrës, drejtori i DAP-it.
3. Drejtori i ASPA-s zgjedh dy përfaqësuesit për këtë institucion jashtë radhëve të nëpunësve të saj.
4. ASPA zgjedh përfaqësuesin e vet nga radhët e personave që plotësojnë këto kriterë:
 - a) të ketë arsim të lartë të nivelit të dytë;
 - b) të ketë një përvojë pune për të paktën 5 (pesë) vjet në administratën publike në pozicione drejtuese, por jo funksione politike dhe në momentin e kandidimit të mos jetë nëpunës civil;
 - c) të mos ketë qenë anëtar i asnjë partie politike për të paktën 3 (tre) vitet e fundit nga data e kandidimit për anëtar të KKP-së;
 - ç) të mos ketë qenë i dënuar penalisht për kryerjen e një veprë penale;
 - d) të ketë cilësi të larta morale dhe profesionale;
 - dh) të mos ketë masa disiplinore në fuqi;
 - e) të mos jetë larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore.
5. Drejtori i ASPA-s shpall hapjen e kësaj procedure në faqen zyrtare të internetit të institucionit. Kandidatët që duan të aplikojnë duhet të paraqesin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dokumentet e mëposhtme:
 - a) diplomën e shkollës së lartë;
 - b) jetëshkrimin (CV);
 - c) vërtetimi nga punëdhënësi aktual apo ai i mëparshëm, ku të përcaktohet vjetërsia në punë dhe fakti nëse ka apo jo masa disiplinore;
 - ç) dëshmi penaliteti;
 - d) deklaratë personale që nuk ka qenë anëtar i një partie politike për 3 (tre) vitet e fundit;
 - dh) vërtetim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme apo vendore të zhvilluara në 3 (tre) vitet e fundit, nën siglën e një partie politike;
 - e) për kandidatin e huaj, dokumentet e mësipërme duhet të kenë vulën “Apostil”, ose të jenë të legalizuara sipas procedurave të zbatueshme dhe të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe.
6. Drejtori i ASPA-s, brenda 5 (pesë) ditëve nga depozitimi i dokumenteve, emëron, me vendim të

motivuar, kandidatët që do të shërbejnë si përfaqësues në KKP për një mandat 2-vjeçar.

7. Përfaqësuesi i TND-së zgjidhet me short të organizuar nga DAP-i, nga radhët e anëtarëve të TND-së. Ai qëndron në detyrë për një mandat 2-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.

8. Personalitetet e pavarura zgjidhen nga Këshilli i Ministrave midis personave që plotësojnë këto kritere:

- a) të ketë mbaruar arsimin e lartë;
- b) të ketë punuar për jo më pak se 5 (pesë) vjet në funksione publike në nivele drejtuese, ose të ketë qenë pjesë e personelit akademik të arsimit të lartë apo Akademisë së Shkencave, ose të ketë titull/gradë shkencore;
- c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- ç) të mos ketë qenë anëtar i partive politike për 3 (tre) vitet pararendëse nga data e kandidimit;
- d) të mos ketë qenë i dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- dh) të mos jetë larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore.

9. KKP-ja njofton 3 (tre) muaj përpara mbarimit të mandatit të njërit prej anëtarëve që vijnë nga personalitetet e pavarura, ministrin përgjegjës për administratën publike. Personat që shprehin vullnetin për të kandiduar depozitojnë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pranë ministrit përgjegjës për administratën publike, kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues, i cili konsiston në:

- a) diplomën e shkollës së lartë;
- b) jetëshkrimin (CV);
- c) vërtetimin nga vendi aktual i punës ose ai i mëparshëm, ku të përcaktohet vjetërsia në punë dhe fakti nëse ka apo jo masa disiplinore;
- ç) vërtetimin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që nuk ka kandiduar në zgjedhje të përgjithshme apo vendore nën siglën e një partie politike në zgjedhjet që përfshijnë periudhën e 3 (tre) viteve të fundit;
- d) dëshminë e penalisht;
- dh) deklaratën personale që nuk ka qenë anëtar i partive politike për 3 (tre) vitet e fundit;
- e) deklaratën personale që nuk ka lidhje nepotike apo konflikt interesi me anëtarët e TND-së;
- ë) dokumentacionin tjetër shtesë, si tituj/gradë akademike, artikuj shkencorë, botime etj.

10. Ministri përgjegjës për administratën publike, pasi verifikon plotësimin e kriterëve formale të kandidatëve, bën dëgjesa publike me të ftuar nga institucionet qendrore, shoqëria civile, bota akademike apo shoqatat e biznesit, me qëllim përzgjedhjen e kandidatëve.

11. Pas realizimit të procedurës së mësipërme, ministri përgjegjës për administratën publike brenda 20 (njëzet) ditëve nga depozitimi i dokumenteve, propozon në Këshillin e Ministrave kandidaturat e përzgjedhura nga procesi i parashikuar sipas pikës 10 të këtij vendimi.

12. Mandati i anëtarit të emëruar nga Këshilli i Ministrave, fillon të nesërmen e ditës së përfundimit të mandatit të anëtarit për të cilin u zhvillua procedura e përzgjedhjes.

13. Në rast se asnjë prej kandidatëve nuk emërohet nga Këshilli i Ministrave, ministri përgjegjës për administratën publike shpall përsëri hapjen e procedurës së përzgjedhjes, sipas pikave 8, 9, 10 e 11 të këtij vendimi.

14. Në rast të mbarimit para kohe të mandatit të njërit prej anëtarëve që vijnë nga personalitetet e pavarura, ministri përgjegjës për administratën publike ndjek të njëjtën procedurë. Në këtë rast, afati i dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Kandidati i emëruar nga Këshilli i Ministrave qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të paraardhësit të tij.

15. KKP-ja mbledhet, organizohet dhe funksionon me pjesëmarrjen e të paktën 2/3 e anëtarëve të tij. Mbledhjet e KKP-së thirren nga 1/3 e anëtarëve të tij. KKP-ja merr vendime me 2/3 e të gjithë anëtarëve, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë vendim. Mbledhjet e KKP-së janë të mbyllura. Procesverbali i mbledhjes mbahet nga përfaqësuesi i sekretariatit teknik.

16. Rastet e papajtueshmërisë, të pamundësisë dhe të konfliktit të interesit për anëtarët e KKP-së zgjidhen në bazë të parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit.

17. Në rastet e parashikuara në pikën 16 të këtij vendimi, për anëtarët e zgjedhur nga ASPA dhe për personalitetet e shquara, KKP-ja njofton, përkatësisht, drejtorin e ASPA-s dhe ministrin përgjegjës për administratën publike. Këshilli i Ministrave dhe drejtori i ASPA-s, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, përzgjedhin anëtarin zëvendësues, duke përcaktuar në vendim funksionet dhe kohën brenda së cilës duhet t'i kryejë.

18. Në rastet e parashikuara në pikën 16 të këtij vendimi, përfaqësuesi i DAP-it dhe përfaqësuesi nga

TND-ja zëvendësohen nga nëpunësi më i vjetër i institucionit të tyre, që vjen drejtpërdrejt pas tij në shkallën e hierarkisë së këtij institucioni.

19. KKP-ja mbështetet nga ana teknike nga administrata e DAP-it, e cila në këtë rast realizon funksionet e sekretariatit.

20. Anëtari i emëruar/zgjedhur nga Këshilli i Ministrave apo drejtori i ASPA-s në KKP, mund të shkarkohen respektivisht nga i njëjti organ në rastet kur:

a) kryen veprimtari në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si edhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij;

b) kryen sjellje dhe akte që diskreditojnë rëndë figurën dhe pozitën e tij si anëtar;

c) mungon pa arsye për më shumë se 2 (dy) herë radhazi në mbledhjet e KKP-së;

ç) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

21. Procedura e lirimt nga detyra për anëtarët që vijnë nga ASPA dhe personalitetet e shquara, fillon nga KKP-ja. Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes (KKP) përgatit një raport dhe bashkë me komentet e personit të interesuar ia dërgon organit respektiv për vendim.

22. Anëtarët e KKP-së që zgjidhen nga ASPA dhe Këshilli i Ministrave paguhen 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj dhe pagesa përballohet nga buxheti i DAP-it.

KREU III

KËRKESAT DHE KUSHTET E PRANIMIT NË TND DHE NË KATEGORINË E NIVELIT TË LARTË DREJTUES PËR INSTITUCIONET E PAVARURA DHE NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

1. Kandidatët për anëtarë të TND/kategorinë e nivelit të lartë drejtues, përveç kërkesave të përgjithshme të parashikuara nga neni 21 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, duhet të plotësojnë edhe kërkesat specifike për kategorinë përkatëse, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për zotërimin e aftësive, njohurive dhe cilësive të përcaktuara në kuadrin e kompetencës, si dhe kushtet e pranimt të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës.

2. Ky kuadër kompetencash konsiston në këto cilësi:

a) Aftësi për të drejtuar dhe menaxhuar veprimet e ndryshme;

b) Aftësi komunikimi;

c) Aftësi të drejtimit strategjik;

ç) Ndërtim i marrëdhënieve ndërpersonale;

d) Efektivitet;

dh) Aftësi pune në grup;

e) Kuptim të gjerë të kompetencave ndërsektoriale;

ë) Njohuri mbi fenomenet sociale dhe ekonomike;

f) Besueshmëri;

g) Vizion;

gj) Të qenët krijues;

h) Integritet;

i) Njohuri për sistemin ligjor evropian.

KREU IV

PROCEDURAT E PRANIMIT NË TND NËPËRMJET ASPA-s

1. Pranimi në programin e formimit të thelluar për TND në ASPA bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, i cili është i hapur për:

a) nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese dhe që përbëjnë jo më pak se 80% të pranimeve;

b) çdo individ tjetër, që nuk është pjesë e shërbimit civil dhe që plotëson kërkesat specifike për pranimin në TND dhe që përbëjnë deri në 20% të pranimeve.

2. Procedura e pranimt realizohet në dy faza, në fazën paraprake të verifikimit të kritereve specifike, të përcaktuara sipas pikave 1 e 2 të kreut III të këtij vendimi dhe në fazën e konkurrimit.

3. Bazuar në planifikimin vjetor, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, procedura e pranimt zhvillohet një herë në vit, sipas kohës së planifikuar nga DAP-i. Nëse është e nevojshme, për shkak të mosplotësimit të numrit të parashikuar sipas planit vjetor të kandidatëve fitues apo për shkak të nevojave të reja që mund të dalin si rezultat i krijimit të vendeve të lira në TND, një procedurë e re pranimi organizohet brenda një periudhe dymujore.

Faza e parë

4. Shpallja e procedurës së pranimit kryhet nga DAP-i në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të tij, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës të parashikuar për zhvillimin e konkurrimit.

5. Shpallja mbahet në portal dhe në faqen zyrtare të DAP-it për gjithë kohën deri në emërimin përfundimtar.

6. Shpallja e konkursit kombëtar në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të DAP-it përmban të paktën këto të dhëna:

- a) numrin e kandidatëve fitues që do të pranohen në ASPA;
- b) përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës;
- c) kriteret e përgjithshme;
- ç) kërkesat specifike të pranimit;
- d) dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave;
- dh) mënyrën e shqyrtimit dhe shpalljen e rezultateve të seleksionimit paraprak;
- e) datën për paraqitjen e aplikimit;
- ë) datën e zhvillimit të konkurrimit;
- f) datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak;
- g) datën për shpalljen e rezultateve për vlerësimin përfundimtar;
- gj) mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar;
- h) mënyrën e njoftimit/komunikimit me aplikantët.

7. Aplikimi për konkursin kombëtar duhet të paraqitet brenda një periudhe të paktën 30-ditore nga momenti fillestar i shpalljes në portal/faqen zyrtare të DAP-it.

8. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi, DAP-i bën verifikimin paraprak të dosjeve të aplikantëve nëse plotësojnë kriteret specifike, të përcaktuara sipas pikave 1 e 2 të kreut III të këtij vendimi. Në përfundim të këtij afati, DAP-i shpall në portalin Kombëtar të Punësimit, në ambientet e tij dhe në ato të ASPA-s, listën e kandidatëve që plotësojnë këto kritere për t’iu nënshtruar konkursit kombëtar, duke i renditur ata sipas rendit alfabetik.

9. Kandidatët që nuk kanë plotësuar kriteret specifike, njoftohen nga DAP-i dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë këtij departamenti për t’u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen në DAP brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e listës, sipas pikës 8 të këtij vendimi. DAP-i duhet të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

10. Me përfundimin e shqyrtimit të ankesave, DAP-i ia përcjell KKP-së listën e kandidatëve që do t’i nënshtrohen procedurës së konkurrimit, të paktën 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së caktuar për zhvillimin e konkursit.

Faza e dytë

11. Faza e konkurrimit konsiston në:

a) Vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;

b) Testimi me shkrim;

c) Intervistën e strukturuar me gojë.

Testimi me shkrim dhe intervista me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, të aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën e kompetencës. Vlerësimi bëhet nga KKP-ja.

12. Të paktën 2 (dy) ditë përpara zhvillimit të konkurrimit, KKP-ja përgatit pyetjet e testit me shkrim dhe me gojë, duke pasur në konsideratë fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

13. Vlerësimi maksimal është 100 pikë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet sipas një procedure që përfshin pikët maksimale për secilën nga fazat e mëposhtme:

a) vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që përfshin në vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, 10 pikë;

b) testim me shkrim, 40 pikë;

c) intervistën e strukturuar me gojë, 50 pikë.

14. KKP-ja merr vendim për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve sipas numrit të pikëve.

15. Secili prej anëtarëve jep vlerësimin e tij individual për secilin kandidat. Vlerësimi për secilin kandidat llogaritet si mesatare e pikëve të vendosura nga secili prej anëtarëve.

16. KKP-ja shpall listën e kandidatëve fitues të renditur me mbi 70 pikë dhe renditjen e tyre duke filluar nga ai

me më shumë pikë.

17. Vendimi merret jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga përfundimi i procedurës së konkurrimit. Lista e fituesve shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në ambientet e DAP-it. Kandidatët që nuk janë shpallur fitues njoftohen nga DAP-i dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë këtij departamenti për t’u njohur me rezultatet e tyre.

18. Kandidatët me pikë të barabarta renditen sipas këtyre kriterëve:

a) në rast se njëri prej kandidatëve përfshihet në kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, atëherë ai përzgjidhet i pari në raport me kandidatin tjetër;

b) në rast se kandidatët janë të gjinive të ndryshme atëherë renditja bëhet duke u renditur i pari kandidati që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar në TND;

c) në rast se nuk mund të aplikohet asnjëra nga alternativat e mësipërme, atëherë renditja e kandidatëve me pikë të barabarta bëhet nëpërmjet shortit.

19. Pa cenuar të drejtën e ankimit gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi, kandidatët kanë të drejtë që të ankohen me shkrim pranë KKP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e rezultatit, sipas pikës 17 të kreut IV të këtij vendimi. KKP-ja merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve dhe, kur është rasti, bën korrigjimin e listës së fituesve të shpallur sipas pikës 17 të kreut IV të këtij vendimi. Vendimi dhe, kur është rasti, lista e korrigjuar, shpallet menjëherë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në ambientet e ASPA-s.

20. Kandidatët fitues të shpallur në listën përfundimtare të KKP-së pranohen të kryejnë programin e formimit të thelluar në ASPA. Ata nënshkruajnë një deklaratë, ku pranojnë që në rast tërheqjeje do të rimbursojnë të gjitha shpenzimet e kryera për trajnimin e tyre.

21. Të drejtat dhe detyrimet e kandidatëve gjatë periudhës së trajnimit rregullohen në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për trajnimet.

KREU V

PROCEDURA E PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND

1. Procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, e parashikuar nga neni 29 i ligjit nr.152/2013, zbatohet vetëm në këto raste:

a) deri në daljen e grupit të parë të anëtarëve të TND-së nga ASPA;

b) nëse prurjet me anëtarë të TND-së nga ASPA nuk janë të mjaftueshme.

2. Përdorimi i procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë vendoset nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike.

3. Një procedurë e caktuar për pranimin e drejtpërdrejtë në TND mund të jetë e hapur edhe për persona jashtë shërbimit civil, sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për administratën publike.

4. Në këtë rast, Këshilli i Ministrave përcakton, shprehimisht, kriteret minimale të pranimit duke pasur parasysh kuadrin e kompetencës, si edhe numrin e pozicioneve që do të pranohen në përputhje me numrin total të pozicioneve, të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit.

5. Për procedurën e drejtpërdrejtë të pranimit në TND zbatohen pikat 4-19 të kreut IV të këtij vendimi.

KREU VI

EMËRIMI NË TND

1. ASPA i njofton DAP-it listën e fituesve dhe renditjen përkatëse të kandidatëve brenda 5 (pesë) ditëve pune, pas zhvillimit të provimit përfundimtar.

2. Kandidatët që përfundojnë formimin e thelluar me, të paktën, 70 pikë, emërohen nga DAP-i si nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së, në bazë të renditjes në provimin përfundimtar të organizuar nga ASPA dhe brenda numrit të miratuar të pranimit në TND.

3. Në procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë, KKP-ja njofton DAP-in për rezultatet e provimeve dhe renditjen e fituesve, brenda 5 ditëve pune nga nxjerrja e rezultatit të testimit.

4. Kandidatët e vlerësuar mbi pragun minimal të 70 pikëve, në procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, sipas radhës së renditjes dhe brenda numrit të miratuar të pranimit në TND, sipas planit vjetor, emërohen nga DAP-i si nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së, brenda 2 (dy) ditëve pune. Nëpunësit e emëruar nga DAP-i si nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së, janë të detyruar të ndjekin programin e formimit të thelluar për anëtarët e TND-së, të organizuar nga ASPA.

KREU VII

CAKTIMI I ANËTARIT TË TND-së NË NJË POZICION TË RREGULLT

1. Një anëtar i TND-së mund të caktohet në një pozicion të rregullt në nivele të larta drejtuese, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 19 të ligjit, ose mund të caktohet si koordinator i posaçëm.
2. Një pozicion i nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore mund të plotësohet vetëm nga anëtarët aktualë të TND-së. Çdo emërim në pozicionin e nivelit të lartë drejtues i bërë në kundërshtim me këtë parashikim, është absolutisht i pavlefshëm.
3. Emërimi në një pozicion të rregullt apo si koordinator i posaçëm, në përputhje me pikën 1 të kreut VII të këtij vendimi, bëhet nga DAP-i sipas kërkesës së titullarit të institucioneve respektive.
4. Titullari i institucioneve respektive, sipas pikës 3 të këtij kreu, është:
 - a) Kryeministri, për çdo pozicion të rregullt në Kryeministri apo në institucionet e varësisë së Kryeministrit;
 - b) ministri, për çdo pozicion të rregullt në ministri apo në institucionet e varësisë së ministrit;
 - c) Kryeministri, zëvendëskryeministri apo ministrat respektivë, për pozicionet e koordinatorit të posaçëm në grupet institucionale apo ndërinstitucionale, ose në projekte të posaçme që janë nën përgjegjësinë e tyre.
5. Lirimi i një anëtari të TND-së nga një pozicion i rregullt apo koordinator i posaçëm bëhet me të njëjtën procedurë të parashikuar në pikën 3 të kreut VII të këtij vendimi.
6. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ky vendim, një anëtar i TND-së i liruar në përputhje me pikën 5 të këtij kreu, qëndron në pritje për t'u caktuar në një pozicion tjetër të rregullt apo si koordinator i posaçëm.
7. Një anëtar i TND-së mundet, gjithashtu, të emërohet në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues ose në një nivel të lartë drejtues në një institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.
8. Emërimi në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues në administratën shtetërore, siç parashikohet në pikën 7 të kreut VII të këtij vendimi, vendoset nga DAP-i, sipas kërkesës së institucioneve respektive dhe me pëlqimin paraprak të anëtarit të TND-së të përfshirë në këtë proces.
9. Emërimi në një pozicion të nivelit të lartë drejtues në një institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, sipas pikës 7 të kreut VII të këtij vendimi vendoset nga institucionet respektive, pas pëlqimit paraprak dhe me shkrim nga DAP-i.
10. Në rastin e parashikuar në pikën 9 të kreut VII të këtij vendimi, DAP-i mund të japë pëlqimin ose të refuzojë kërkesën, në varësi të nevojave të TND-së dhe vetëm pasi ka marrë pëlqimin e anëtarit të TND-së të përfshirë në këtë proces.
11. Në rast nevojë të TND-së, mbështetur në kërkesën e titullarit të institucionit, parashikuar në pikën 4 të kreut VII, të këtij vendimi, emërimi në përputhje me pikat 8 dhe 9 të kreut VII të këtij vendimi, përfundon dhe anëtari i TND-së caktohet në një pozicion të rregullt apo si koordinator i posaçëm.
12. Kohëzgjatja e shërbimit në një pozicion, sipas përcaktimit në pikën 7 të kreut VII të këtij vendimi, konsiderohet si kohë shërbimi në një pozicion të rregullt për qëllimet e pikave 1, 2 e 3 të kreut VII të këtij vendimi dhe të pikës 2 të nenit 66 të ligjit nr. 152/2013.
13. Një anëtar i TND-së, që emërohet në një pozicion të rregullt, paguhet sipas pozicionit respektiv. Paga paguhet nga institucioni ku është caktuar.
14. Një anëtar i TND-së, në pritje për t'u caktuar apo i caktuar si koordinator i posaçëm, merr një pagë si më poshtë:
 - a) për dy vitet e para paguhet me pagën që i përket klasës më të ulët për kategorinë e nëpunësve të lartë drejtues;
 - b) nëse nuk emërohet në një pozicion të rregullt për, të paktën, 6 (gjashtë) muaj në dy vitet e para, do të marrë 50% të pagës që i përket klasës më të ulët për kategorinë e nëpunësve të lartë drejtues për dy vitet e ardhshme;
 - c) nëse nuk emërohet në një pozicion të rregullt për, të paktën, 8 (tetë) muaj në katër vitet e para, mbetet anëtar i TND-së pa pagë.
15. Paga në rastin e parashikuar në pikën 13 të kreut VII të këtij vendimi, paguhet nga buxheti i Kryeministrit.
16. Një anëtar i TND-së, i emëruar në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues në administratën shtetërore, ka pagën e pozicionit respektiv. Paga paguhet nga vetë institucioni.
17. Një anëtar i TND-së, i emëruar në një pozicion të një niveli të lartë drejtues në institucionet e pavarura apo njësitë e qeverisjes vendore, paguhet me pagën e pozicionit respektiv nga vetë institucioni.

KREU VIII

PROCEDURA E PRANIMIT NË KATEGORINË E NIVELIT TË LARTË DREJTUES PËR INSTITUCIONET E PAVARURA DHE NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

1. Pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore bëhet me konkurrim të organizuar për një apo disa pozicione pune të lira dhe është i hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese të shërbimit civil.

2. Procedura e pranimit organizohet nga njësia përgjegjëse e institucionit të pavarur/qeverisjes vendore dhe është e organizuar në dy faza, në fazën seleksionuese dhe në atë konkurruese.

3. Bazuar në planifikimin vjetor për institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore, procedura e pranimit në kategorinë e lartë zhvillohet sipas nevojave të vetë institucionit.

Faza e parë

4. Shpallja e procedurës së konkurrit dhe të gjithë hapat e tjerë bëhen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e tyre zyrtare, dhe në ambientet e tyre të brendshme, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës të parashikuar për zhvillimin e konkurrit.

5. Shpallja mbahet në portal, faqen e internetit dhe në ambientet e brendshme për të gjithë kohën deri në shpalljen e fituesit.

6. Shpallja e përmendur më sipër përmban, të paktën, këto të dhëna:

- a) pozicionin e punës për të cilin zhvillohet konkurrimi;
- b) përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës;
- c) kriteret e përgjithshme;
- ç) kërkesat specifike të pranimit;
- d) dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes të kandidaturave;
- dh) mënyrën e shqyrtimit dhe shpalljen e rezultateve të seleksionimit paraprak;
- e) datën për paraqitjen e aplikimit;
- ë) datën e zhvillimit të konkurrit;
- f) datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak;
- g) datën për shpalljen e rezultateve për vlerësimin përfundimtar;
- gj) mënyrën e vlerësimit, njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar;
- h) mënyrën e njoftimit/komunikimit me aplikantët.

7. Aplikimi për konkursin kombëtar duhet të paraqitet brenda një periudhe të paktën 30-ditore nga shpallja për zhvillimin e konkurrit.

8. Kandidatët duhet të paraqesin pranë institucionit të pavarur/njesisë së qeverisjes vendore dokumentacionin, sipas kërkesave të përcaktuara në shpallje.

9. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 7 të kreut VIII të këtij vendimi, njësia përgjegjëse për institucionin e pavarur/njesisë e qeverisjes vendore bën verifikimin paraprak të dosjeve të kandidatëve nëse plotësojnë kriteret specifike. Në përfundim të këtij afati, njësia përgjegjëse shpall në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare në internet dhe në ambientet e përcaktuara nga njësia e qeverisjes vendore listën e aplikuesve që plotësojnë kriteret specifike, për t’iu nënshtruar konkursit kombëtar, duke i renditur ata sipas rendit alfabetik.

10. Kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar njoftohen nga njësia përgjegjëse dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë saj, për t’u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës sipas pikës 9 të kreut VIII të këtij vendimi, në njësinë përgjegjëse. Njësia përgjegjëse duhet të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune e, kur është rasti, bën korrigjimin e listës dhe merr masa për publikimin e listës së korrigjuar.

Faza e dytë

11. Me përfundimin e shqyrtimit të ankesave, njësia përgjegjëse i përcjell Komitetit të Përhershëm të Pranimit (KPP) të institucionit të pavarur/njesisë së qeverisjes vendore listën e kandidatëve që do t’i nënshtrohen procedurës së konkurrit.

12. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komitetit të Përhershëm të Pranimit për institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore rregullohen nga vendimi i Këshillit të Ministrave për rekrutimin e nëpunësve civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese.

13. Njoftimet për procedurën e pranimit, që nga momenti i shpalljes së procedurës e deri në shpalljen e fituesit, bëhen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare në internet të institucionit/njesisë së

qeverisjes vendore dhe në ambientet e përcaktuara nga njësia e qeverisjes vendore.

14. KPP-ja për institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore ndjek, më pas, procedurën e përcaktuar në pikat 4-19 të kreut IV të këtij vendimi.

KREU IX

EMËRIMI I ANËTARËVE TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE INSTITUCIONET E PAVARURA

1. Kandidatët e renditur të parët dhe mbi prapun minimal të 70 pikëve, në procedurën e pranimi në kategorinë e lartë drejtuese, organizuar nga institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore, emërohen në nivelin e lartë drejtues në pozicionin përkatës për të cilin është zhvilluar procedura e pranimi.

2. KPP-ja, për institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore, njofton brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e rezultateve, njësia përgjegjëse për fituesit dhe renditjen e tyre sipas pikëve. Njësia përgjegjëse, brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja dijeni, nxjerr aktin e emërimit, në bazë të propozimit për përzgjedhjen e kandidatit/kandidatëve nga eprori direkt.

KREU X

PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIEVE NË SHËRBIMIN CIVIL

1. Anëtari i TND-së lirohet nga shërbimi civil kur nuk është caktuar në një pozicion të rregullt për, të paktën, 8 (tetë) muaj në një periudhë 5-vjeçare.

2. Konstatimi për kohëzgjatjen e përcaktuar në pikën 2 të nenit 66 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, bëhet nga DAP-i, i cili menjëherë bën aktin e lirimit.

3. Në rastet e tjera të lirimit, të përcaktuara nga ligji, njësia përgjegjëse njoftohet nga titullari apo organi përkatës. Me marrjen e njoftimit, njësia nxjerr aktin e lirimit.

KREU XI

DISPOZITAT TRANSITORE DHE TË FUNDIT

1. Përjashtimisht, në planin vjetor të pranimi në institucionet e administratës shtetërore, për vitin 2014, apo me vendim të veçantë, Këshilli i Ministrave përcakton numrin e anëtarëve të TND-së që do të pranohen drejtpërdrejt në TND, sipas procedurave të parashikuara në nenin 29 të ligjit nr. 152/2013.

2. Për 5 (pesë) personalitetet e para të pavarura për anëtarë të KKP-së, procedura organizohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Në mbledhjen e parë të KKP-së organizohet shorti për të përcaktuar radhën dhe mënyrën e zëvendësimit me rotacion të anëtarëve të parë, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të nenit 31 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

4. DAP-i/njësia përgjegjëse, deri në rregullimin e portalit “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” për pranimin në shërbimin civil, mund të përdorë çdo mjet tjetër që garanton njoftimin e aplikuesve, duke zbatuar rregullat mbi njoftimet sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama